

## Vendim nr. 98 datë 09.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 09.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (V) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** VELI DRIZI, përfaqësuar nga avokat Gëzim Allaraj, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 5252, datë 30.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 2762, datë 22.09.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2023-2733, datë 30.06.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 15, 18, 42, 43, 59, paragrafi 1, shkronja “ë”, 131, shkronja “f”, 134, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

## Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Veli Drizi është sportist i ekipit kombëtar të Federatës Shqiptare të Mundjes. Në datat 14-16.10.2011 kërkuesi ka marrë pjesë në Kampionatin Botëror të Mundjes, stil i lirë, për veteranët, i cili është zhvilluar në Tiranë, duke fituar vendin e parë, në peshën 85 kg. Gjithashtu, në datat 18-23.09.2012 ai ka marrë pjesë edhe në Kampionatin Botëror të Mundjes, stil klasik, për veteranët, i cili është zhvilluar në Budapest, Hungari, duke zënë vendin e dytë. Në datën 09.05.2014 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt detyrimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për ta shpërblyer respektivisht në shumën 10.000.000 lekë dhe 6.000.000 lekë për shkak të arritjeve të tij në dy kampionatet, duke i mbështetur pretendimet e tij në ligjin nr. 9376, datë 21.04.2005 “Për sportin”, të ndryshuar (*ligj nr. 9376/2005*) dhe VKM-në nr. 1720, datë 29.10.2008 “Për kriteret e përcaktimit të niveleve të larta sportive për mënyrën e shpërblimit të sportistëve”, të ndryshuar (*VKM nr. 1720/2008*).

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5252, datë 30.09.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe në ligj, vendim i cili është kundërshtuar nga kërkuesi. Me vendimin nr. 2762, datë 22.09.2016, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

3. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2023-2733, datë 30.06.2023 ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

4. Në datën 13.03.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000 me aktet e kërkuara, është regjistruar në datën 26.03.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *standardit të arsyesimit të vendimit*, pasi të tria gjykata kanë rrëzuar kërkesëpadinë me

argumentin se ai nuk është subjekt përfitues i ligjit nr. 9376/2005 dhe VKM-së nr. 1720/2008 për sa i përket shpërblimit dhe kriterëve të sportistëve përfitues. Gjykatat kanë interpretuar gabim ligjin material, konkretisht nenin 26 të ligjit nr. 9376/2005 dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij. Ndonëse gjykatat kanë arsyetuar se sporti i mundjes për veteranë nuk përfshihet në këto akte ligjore e nënligjore, këto të fundit parashikojnë dispozita me karakter përgjithësues, duke mos e përjashtuar aktivitetin e zhvilluar nga kërkuesi. Për rrjedhojë, kërkuesit i është cenuar *e drejta për shpërblim të drejtë*.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

7. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi..

8. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj

vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

9. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në lidhje me datën e fillimit të afati ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka vlerësuar se është ajo e marrjes dijene efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijene konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijene konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë në datën 13.03.2024 për kundërshtimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 30.06.2023. Nga komunikimi me Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, me shkresën nr. 1831/1 prot., datë 15.04.2024, është përgjigjur se “*sipas verifikimeve me specialistët e IT-së rezulton se vendimi me nr. 00-2023-2733, datë 30.06.2023 është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në datën 30.01.2024, datë në të cilën palët mund ta dispononin këtë vendim*”. Për rrjedhojë, duke konsideruar këtë të fundit si datën nga e cila ka filluar afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae* kërkuesi ka pretenduar se është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit dhe shpërblimit të drejtë. Për sa i përket këtij të fundit, duke mbajtur në konsideratë se pretendimet e kërkuesit lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij, Kolegji çmon ta analizojë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Për rrjedhojë, në vijim do të analizohet pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

*B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit*

12. Kërkuesi ka pretenduar se të tria gjykata kanë rrëzuar kërkesëpadinë me argumentin se kërkuesi nuk është subjekt përfitues i ligjit nr. 9376/2005 dhe VKM-së nr. 1720/2008 për sa i përket shpërblimit dhe kritereve të sportistëve përfitues, duke interpretuar gabim ligjin material, konkretisht nenin 26 të atij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Ndonëse gjykatat kanë arsytuar se sporti i mundjes për veteranë nuk përfshihet në këto akte ligjore e nënligjore, këto të fundit parashikojnë dispozita me karakter përgjithësues, duke mos e përjashtuar aktivitetin e zhvilluar nga kërkuesi.

13. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsytuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se referuar ligjit nr. 9376/2005 sportistët janë amatorë dhe joamatorë, sipas kushteve të përcaktuara në statutet dhe rregulloret e federatave sportive kombëtare. Sportistë amatorë janë ata sportistë që praktikojnë sportin e tyre dhe nuk kanë ndonjë kontratë pune të lidhur me klubin sportiv ose shoqatën ku janë regjistruar. Sportistë joamatorë janë ata sportistë që për praktikimin e sportit të tyre nënshkruajnë me klubin sportiv ose shoqatën ku janë regjistruar sipas ligjit: a) një marrëveshje juridiko-civile për shërbimin e ofruar; b) një kontratë individuale pune, duke përfituar statusin e sportistit profesionist (*neni 23/1*).

15. Ndërsa sipas pikës 1.1 të VKM-së nr. 1720/2008, sportistët e nivelit të lartë klasifikohen sipas rezultateve të larta sportive të arritura në veprimtaritë ndërkombëtare dhe kombëtare, ku për të parat kriteret për përcaktimin e nivelit të lartë sportiv, për të rritur, në sportet individuale, në përbërje të ekipit kombëtar dhe të ekipeve kombëtare të sporteve kolektive, si futboll, basketboll, volejboll, atletikë, gjimnastikë, not, peshëngritje, boks, mundje, xhudo e qitje, janë rezultatet e arritura në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare, sipas klasifikimeve përfundimtare të përcaktuara në rregulloret ndërkombëtare të këtyre sporteve për sportistin i cili thyen rekord olimpiq, botëror, evropian, vendet e parë deri të gjashtë në lojërat olimpike, vendet e parë deri në të pestë në kampionate botërore dhe vendi i parë deri në të tretë në kampionatin evropian si dhe vendi i parë në lojërat mesdhetare. Kriteret për përcaktimin e nivelit të lartë sportiv në veprimtaritë kombëtare janë rezultatet e arritura në këto veprimtari për sportistin i cili thyen rekord kombëtar dhe vendi i parë në kampionatin kombëtar (*pika 2.1*).

16. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe në ligj, duke arsyetuar se kërkuuesi nuk rezulton të ketë nënshkruar me ekipin kombëtar të mundjes pranë Federatës Shqiptare të Mundjes ndonjë kontratë individuale pune ose marrëveshje juridiko-civile për shërbimin e ofruar sipas nenit 23 të ligjit nr. 9376/2005, për rrjedhojë ai konsiderohet sportist amator dhe ka statusin e sportistit veteran, sepse ushtron veprimtari sportive pasi e ka lënë sportin. Po kështu, referuar VKM-së nr. 1720/2008, shpërblimi parashikohet, ndër të tjera, për sportistët aktivë që vazhdojnë aktivitetin e tyre pranë një ekipi ose shoqate mbi bazën e një kontrate ose marrëveshjeje dhe jo për sportistët veteranë. Gjithashtu, në Rregulloren e Përgjithshme për Kampionatin Botëror të Veteranëve të Organizatës Ndërkombëtare të Mundjes këto aktivitete zhvillohen me qëllim promovimin e sportit të mundjes dhe Federata nuk merr përsipër të paguajë kostot mjekësore ose shpenzimet e pjesëmarrjes në aktivitet. Për rrjedhojë, sipas kësaj gjykate, në kushtet kur ligji nuk ka përcaktuar shpërblim të veçantë për këtë kategori, kërkesëpadia duhet të rrëzohet (*shih faqet 7-8 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

17. Mbi ankimin e kërkuessit, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me të njëjtin arsyetim. Kjo gjykatë ka argumentuar gjithashtu se Kampionati Botëror i Mundjes dhe Kampionati Botëror Mundjes për veteranët janë dy veprimtari ndërkombëtare të ndryshme dhe, për pasojë, ky i fundit nuk përcaktohet si veprimtari ndërkombëtare që përfshihet në VKM-në nr. 1720/2008. Për këtë shkak, veprimtaria e kryer nga

kërkuesi nuk klasifikohet si kategori për të cilën sportisti mund të përfitojë shpërblim. Po kështu, gjykata e apelit ka vlerësuar se pikërisht për këtë arsye Federata Sportive e Mundjes nuk i ka propozuar Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhënien e shpërblimit të veçantë për kërkuesin (*shih faqet 8-9 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

18. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se në rekurs nuk ngrihen problematika që të bëjnë të mendohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin material ose procedural dhe që ky keqzbatim është i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Po kështu, nuk pretendohet se vendimi bie ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ ose vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe asnjë shkelje e rëndë e normave procedurale nuk është parashtruar nga kërkuesi në mjetin e tij të ankimit para Gjykatës së Lartë. Kolegji Administrativ ka pohuar se të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, duke i bërë një analizë të hollësishme dispozitave të ligjit, të cilat rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim. Gjithashtu, ky kolegji ka arsyetuar se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Nëpërmjet rekursit dhe gjykimit në Gjykatën e Lartë nuk mund të pretendohet të rihapet edhe një herë shqyrtimi gjyqësor i provave (*shih paragrafët 11-12 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

19. Për sa më lart, nga përmbajtja e vendimeve të kundërshtuara, Kolegji konstaton se gjykatat më të ulëta kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin dhe aktet nënligjore ku janë bazuar në zgjidhjen e çështjes, duke arritur në të njëjtin përfundim. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila ka arsyetuar se veprimtaria e ushtruar nga kërkuesi nuk përfshihej në aktet nënligjore përkatëse, me qëllim marrjen e shpërblimit. Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të ketë kundërthënie dhe të mos ketë respektuar standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe nuk rezulton të ketë interpretuar në mënyrë haptazi të paarsyeshme ose arbitrare dispozitat ligjore të zbatueshme në rastin e kërkuesit. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit janë haptazi të pabazuara.

20. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.